

# Wallachia dhe Moldavia

Petre Petcut

Vendosja në rumani | Liria dhe skllavëria | Si ishte e mundur skllavëria? | Statusi ligjor i romëve në skllavëri | Legjislacioni | Aspektet e jetës skllave | Emancipimi i romëve të pronësuar nga kisha. Dekreti i 1847 | Fundi i skllavërisë

➤ *Ndryshe nga çdo regjion tjetër evropian, romët në ish Wallachia dhe Moldavi (Rumania e sotme), kanë jetuar në skllavëri për pesëqind vjet. Në gjysmën e shekullit të 19-të, kur skllavëria u shfuqizua zyrtarisht, një numër i madh i romëve braktisën vendin dhe migruan në Evropën qendrore dhe perëndimore si dhe në Amerikë.*


## PARATHËNIE

Historia e migrimit të romëve në Evropë u ndërpre befasisht për ata romë të cilët kishin arritur në territoret rumune të Maleve Karpate jugore dhe lindore. Romët të cilët kishin arritur në Wallachia dhe Moldavia në gjysmën e dytë të shekullit të 14-të ishin shtrënguar në varësi të plotë dhe skllavëri për pesë shekuj, dhe historia e tyre ishte shënuar nga një moment kthyes që ishte i krahasueshëm vetëm me skllavërimin e popullatës Afro-Amerikane në Shtetet e Bashkuara.

“Ciganët do të lindin vetëm skllavër; kushdo që lind nga një nënë skllave gjithashtu do të bëhet skllav ...” thoshte kodi i Wallachia në fillim të shekullit të 19-të. Romët ishin pronësuar nga Princi (si “skllav të Shtetit” – “tigania domneasca”), manastiret dhe individët privatë. Shitja, blerja dhe dhurimi i familjeve të tëra skllave ishte një gjë e zakonshme në mesin e pronarëve, të cilët kishin të drejta të pakufizuara ndaj skllavëve të tyre. Në fakt skllavopronarët mund të bënin çdo gjë që dëshironin me skllavërit e tyre, përveç t’i vrisnin.

Drejt mesit të shekullit të 19-të, një lëvizje abolicioniste u formua nga intelektualët në Principatat Danubiane, dhe figura e “Ciganit” u bë temë e shpeshtë në artikujt e gazetave, poezi, li-

FORMIMI I RUMANISË  
III. 1



teraturë dhe shfaqje. Posa u arrit emancipimi i skllavëve, kjo lëvizje ngriti – dhe ngriti madje edhe sot – çështjen e integritetit të tyre në jetën sociale dhe ekonomike të Rumanisë.


Gjurmët e skllavërisë u ngulmuan në kujtesën e ish pronarëve dhe skllavëve, dhe periudha e skllavërisë ka njollësuar marrëdhëniet në mes të pasardhësve të këtyre dy shtresave sociale deri më sot.

Vendosja në Rumani

Liria dhe skllavëria

Si ishte e mundur skllavëria?

Statusi ligjor i romëve në skllavëri



III. 2

Fatura e shitjes për një grup të skllavëve romë, 1558

(nga Hancock 2002, f. 22)

## STEFAN RAZVAN, ROMË DHE LORD I MOLDAVISË

Rastet kur romët arritën të tejkalojnë barrierat shoqërore dhe realizuan një qëndrim të mirë në strukturën publike në principata janë më shumë përjashtime sesa rregull. Rasti i Stefan Razvan, i cili u bë princ, është shumë i njohur. Ekzistojnë versione të ndryshme për origjinën e tij. Sipas njëres nga to, ishte djali i një rumuni, bujkrob, ndërsa babai i tij kishte qenë një skllav cigan i Princit Mihai Vitezul nga Wallachia. Sipas një versioni tjetër, i

përhapur në literaturë, ai ishte djali i një skllavi cigan të Princit të Wallachisë, dhe babai i tij ishte i panjohur, me gjasë një përfaqësues i lartë zyrtar i disave nga dinastitë në principatë. Si fëmijë, Stefani ishte skllav i Anastasit, metropolitani i Moldavisë në vitet 1572 - 1578, i cili i kishte dhënë edukim të mirë, dhe rrjedhimisht në testamentin e tij, metropolitani e liroi. Jeta e Stefan Razvan ishte goxha e trazuar. Ai u bë një aristokrat (ndryshe nga Evropa qendrore dhe perëndimore, në Wallachi dhe Moldavi, si dhe në tërë botën ortodokse, ku aristokracia nuk ishte një kategori trashëguese e mbyllur, kjo ishte e mundur), ai u bë zyrtar i qe-

## VENDOSJA NË RUMANI

Dëshmia e parë e pakontestueshme e romëve në veri të Danubit gjithashtu përbën dëshminë e parë të skllavërisë. Në vitin 1385, Dan I, Voivoda i Wallachia, konfirmoi pronën e dhënë Manastirit të Virgjërshës Mari, Tismana, përfshirë 40 "salashe" (shprehje e marrë nga turqishtja, që nënkuptonte familjet ose komunitetet e tendave) të "Atigani" ("Ciganët").

Një donacion prej 300 "salashe" të "Ciganëve" i ishte bërë manastirit Cozia në vitin 1388, nga Lordi Mircea i Vjetri. Dëshmitë e mëtejme dokumentuese shfaqen gjatë dekadave të ardhshme. Skllavërit romë të manastirit Tismana përmenden në të gjitha dokumentet duke konfirmuar posedimet e tyre, deri në shekullin e 17-të.

Një dokument i 2 gushtit, 1414, i lëshuar në Suceava, Moldavia, përmend Aleksandrin e Mirë, i cili i jep Toader xhuxhit, për "shërbimet e tij besnike", një fshat në brigjet e Jeravatit i cili rrjedh në Bârlad, apo më saktësisht ku "Lie" dhe "Tiganestii" ishin "cnezi" (padron lokal). Historianët e konsiderojnë këtë dokument si dëshmi të parë dokumentare indirekte të romëve në Moldavia, dhe një dokument nga 8 korriku, 1428 si një dëshmi të parë direkte. Në këtë të dytën, Voivoda Aleksandri i Mirë kishte pajisur manastirin me "chelyadi" (një shprehje e marrë nga gjuhët sllave, e njëjtë në kuptim me "salash") për "Ciganët".

## LIRIA DHE SKLLAVËRIA

Disa historianë besojnë se rumunët morën institucionin e skllavërisë nga

fqinjët e tyre lindor, Tartarët. Ishte e zakonshme për këta të fundit ti trajtojnë të burgosurit e luftës si skllavë, një fat i përjetuar nga shumë rumun, dhe anasjelltas: me 1402, Aleksandri i Mirë i dha manastirit Moldovita katër familje tartare si skllavë. Sidoqoftë, skllavëria ishte e njohur në regjion para se romët të arrinin.

Historianët besojnë se, në migrimin e tyre prej Greqisë dhe Bullgarisë drejt Evropës qendrore dhe perëndimore, një numër domethënës i romëve kaluan përmes Wallachisë dhe pastaj Moldavisë. Kështu që duhet të ketë qenë një periudhë fillestare gjatë së cilës romët në këtë regjion ishin të lirë. Në Wallachia, dokumenti i vitit 1385 nga Voivoda Dan I nuk na tregon asgjë për statusin e tyre ligjor para atij donacioni. Në Moldavia, dokumentet e hershme i referohen romëve si "cnezi" (padron të fshatit,



III. 3  
Auguste Raffet, "Familie tsigane en voyage en Moldavie",  
19 Korrik, 1837. (nga Hancock 2002, f. 28)



III. 4  
Gërmuesit romë të arit ("Rudari"/"Aurari"/"Bayash") në punë.  
Vizatimi, diku rreth 1850 (nga Gronemeyer / Rakelmann 1988, f. 125)

verisë, u dërgua në mision diplomatik në Stamboll, pastaj shkoi në "Zaporozhskaia Sech" (një formacion i pavarur i Kozakëve në territorin e Ukrainës së sotme), duke arritur pozitën e "Hetman" (komandant i forcave Kozake), shërbeu në ushtrinë polake nën Mbretin Sigismund III Batory me rangun e kolonelit dhe me një titull fisnik, dhe u kthye në Moldavi për tu bërë komandant i rojeve personale të Princit Aron Tiranul. Në konfliktin e brendshëm në Wallachia dhe Moldavi në vitin 1595, Stefan Razvan arriti të mposht Princin Aron Tiranul dhe mori fronin e princit për pesë muaj (prej prillit deri në gusht të 1595) me përkrahjen e Polo-

nisë. Derisa luftonte suksesshëm me ushtritë otomane në Wallachia, ai pushtoi Bukureshtin, Giurgiuin, Brailan, Targovishten dhe Ismailin e rrethuar. Në këtë kohë aristokrati Ieremia Movila ishte shpallur Princ i Moldavisë, gjithashtu me përkrahjen polake. Sidoqoftë, Stefan Razvan u kthye në Moldavi me 14 Dhjetor, 1595 dhe u mposht në betejën e Arenit nga ushtria e bashkuar e Mbretit Sigismund III dhe Princit Ieremia Movila, dhe u ekzekutua me 6 mars, 1596.

III. 5  
(ofruar nga Elena Marushiakova / Veselin Popov)

fisnikëri e vogël; dhe prandaj njerëz të lirë); në rastin e Transilvanisë, romët ishin gjithmonë të lirë (statusi i tyre ligjor ishte identik me fshatarët robër).

Hipoteza e periudhës fillestare të lirisë për romët konfirmohet nga një varg i tërë i lirive që iu dhuruan skllëvërve nga pronarët e tyre. Më e vlefshmjia nga këto ishte liria e lëvizjes brenda vendit (ku nomadët thjesht paguanin një taksë vjetore padronëve të tyre), dhe autonomia e brendshme gjyqësore kryesisht për komunitetet nomade.

### SI ISHTE E MUNDUR SKLLAVËRIA?

Një zakon lokal kërkonte nga fshatarët e lirë, të cilët kishin punuar në pronat feudale për dymbëdhjetë vjet të, bëheshin bujkrobër ("rumani") të padronit.

Është një arsye që na bën të besojmë se romët trajtoheshin barabartë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm së njëjtë ishte dobësimi i shtetit përballë autoritetit të fisnikërisë. Sovrani nuk mund të ushtronte autoritet efektiv në tërë vendin që t'i mbante skllëvërit e tij nën ndikim të drejtpërdrejtë. Romët ishin detyruar në skllavëri nga padronët lokal.

Ekzistenca e skllëvërve romë në Wallachia dhe Moldavia pësoi një ndryshim të mahnitshëm me ndryshimet në gjendjen financiare të padronëve. Shitja e skllëvërve ishte mënyra më e përshtatshme për pagimin e borxheve dhe për shpengimin nga skllavëria turke ose tartare. Skllëvërit ishin të mirë për çdo gjë, të barabartë me çfarëdo vlere, shiteshin, dhuroheshin si dhurata të martesës ose prikë, dhuroheshin në manastire që emri i padronit të përmendej gjatë meshës, dhe shkëmbe-

heshin me kafshë ose pantallona; dhe nëse nuk nënshtrroheshin, "ata duhet të rrihen shumë". [III. 2, 10]

### STATUSI LIGJOR I ROMËVE NË SKLLAVËRI

Nga shekulli i 14-të deri në shekullin e 16-të, statusi ligjor i romëve nuk ishte nënshtruar ndonjë rregulloreje të shkruar që parashihte konfliktet e ndryshme që mund të ndodhin në mes tyre dhe njerëzve të tjerë. Sidoqoftë, qëndrimi i "gjatë" ndaj romëve gradualisht u mbart në ligje të cilat u miratuan në mes të shekujve 17-të dhe 19-të. Rregulloret e Moldavisë u plotësuan nga ato të Wallachisë, pa ndonjë dallim të madh në mes të dy vendeve rumune lidhur me statusin ligjor të skllëvërve. [III. 7]

| PUNUESIT E LUGËVE  | GËRMUESIT E ARIT   | “URSARI GYPSIES”   |
|--|--|--|
| <i>Zanati i tyre ishte punimi me dru; ata bënë kova të madhësive të ndryshme, boshte, lugë, dhe enë tjera shtëpiake.</i> | <i>Disa nga ta jetonin nga të ardhurat prej arit që zbulonin. Të tjerët bënë punime druri.</i> | <i>Ata mbanin arinj dhe siguronin jetesën duke i detyruar arinjtë të vallëzojnë në qytete dhe fshatra.</i> |

III. 6

*Raporti i katër anëtarëve të komitetit hetues ndau romët në gjashtë “kategori”, sipas profesioneve dhe zakoneve të tyre (1831)*

(ofruar nga autori; shkurtuar dhe përkthyer nga Analele parlamentare ale României, Bucuresti, Imprimeria Statului, 1890, I/I)

### PRONARËT DHE SKLLEVËRIT: TRI KATEGORI, DY SITUATA

III. 7 (ofruar nga Elena Marushiakova / Veselin Popov)

*Romët ishin pronë e princit (“skllevërit e Kurorës”, më vonë të quajtur edhe “Ciganët e shtetit”), manastireve dhe individëve privat. Ata të cilët i përkisnin manastireve apo individëve privat, aristokratëve, gjithmonë ishin në një pozitë më të vështirë sesa ata që i përkisnin princit. Ndërlíkueshmëria e marrëdhënieve ekonomike, religjioze, dhe familjare në mes të klasës sunduese rumune rezultoi në një numër të ndryshmeve të pronarëve dhe skllevërve (skllevërit i nënshtroheshin blerjeve, shitjeve, donacioneve për manastiret, trashëgimive dhe prikave)*

*“Skllevërit e Kurorës” ishin kryesisht nomadë me profesione të ndryshme. Skllevërit e manastirit kishin zanate të ndryshme, ku vetëm disa prej tyre ishin nomadë, dhe shumica punonin tokën e manastireve, ndërsa të tjerët ishin zejtarë. “Ciganët” e aristokratit ishin kryesisht shërbëtor dhe ndihmës shtëpiak ose punonin tokën.*

*Një klasifikim alternativ i skllevërve “Ciganë” i ndante ata në grupe të vendosura dhe nomade dhe sipas zanateve të tyre. “Ciganët e shtetit” u ndanin në “Rudari”, “Aurarii” ose “Bayashi”, dhe pastronin arin; “Ursari”, ishin udhëheqës të arinjve ose tregtar hekurishtesh; “Lingurari”, që prodhonin enë shtëpiake nga druri; dhe “Layashi”, që ishin farkëtar, tregtar hekurishtesh, krehër bërës, etj. Ata jetonin një jetë nomade dhe nevojiteshin ti paguanin shtetit taksat vjetore. “Ciganët” e manastirit dhe aristokratit, varësisht nëse ishin nomadë apo të vendosur, ndaheshin në “Layashi”, mënyra e jetës të së cilëve ishte e ngjashme me atë të “Layashi”, dhe “Vatrashi” të princit, të cilët ishin të vendosur. Në anën tjetër “Vatrashi” ndaheshin në dy kategori, “Tigani casasi” (“Ciganët” që punonin në shtëpi) ose “tigani de curte” (“Ciganët” shtëpiak) të cilët ishin shërbëtor shtëpiak, dhe “Tigani de ogor” ose “Tigani de câmp” (që punonin tokën e pronarit të tyre).*

Gjatë tërë periudhës në të cilën romët ishin të skllavëruar në dy vendet rumune, ata nuk kishin ndonjë status ligjor që do tu siguronte të drejtat minimale ose që do ti mbronte ata gjatë proceseve gjyqësore. Skllavi nuk është konsideruar person ligjor, por është klasifikuar si pronë e padronit. Një konflikt në mes të një skllavi dhe një personi të lirë i cili nuk ishte pjesë e familjes skllavopronare bëhej një konflikt në mes të padronit të skllevërve dhe personit në fjalë. Skllevërit nuk ishin përgjegjës për veprimet e tyre, që ishin brengë e pronarit të tyre. Në rastet më serioze (vjedhje e kuajve, vrasje), sidoqoftë, pronari mund të braktiste skllavin dhe kështu nuk kishte më nevojë të paguante kompensim ose gjoba (“desegubina”); skllavi duhej t’i nënshtrohej dënimit, që mund të ishte dënim me vdekje.

### LEGJISLACIONI

Në vitin 1646, kodi i parë legjislativ, i quajtur “Carte romneasca de invatatura” (libri rumun i edukimit), caktoi një numër të standardeve lidhur me të drejtat dhe obligimet e skllevërve romë në Moldavi. Për shembull, nga një skllav i blerë kërkohet ti ndihmonte pronarit të tij, dhe skllavi i cili mbahej fajtor për ndonjë gjë duhet ti nënshtrohej dënimit të “arsyeshëm” të administruar me “shkop ose kamxhik”, dhe mund të kundërshtonte vetëm nëse pronari përdorte armët e “zhveshura”, në të cilin rast skllavi ishte në rrezik të vritej. Në fakt, skllavopronarët mund të bënin çfarëdo që donin me skllevërit e tyre, përveç ti vrisnin.

Lidhur me martesën, instrumentet ligjore parashihnin që dy skllevër mund të martoheshin, por vetëm nëse pronari

pajtohej. Nëse dy skllevër që i përkisnin dy pronarëve të ndryshëm dëshironin të martoheshin, pajtimi i të dy pronarëve ishte i nevojshëm. Në shumicën e rasteve, dy pronarët arrinin një marrëveshje para martesës: ose njëri pronar blinte skllavin, që do të vinte në pronën e tij përmes martesës, nga pronari tjetër, ose bëhej shkëmbim, ku pronari ofronte një skllav me vlerë të njëjtë në shkëmbim me skllavin e marrë. Në situata të tilla, shumica e dokumenteve saktësonin “Cigani për Cigan, sipas ligjit”.

Në fillim të shekullit të 19-të, Kodi Civil i Moldavisë ishte përpiluar kryesisht për garantimin e të drejtave të pronarit ndaj skllavit. Kapitulli III i Kodit parashihnin se “nuk mund të ketë një bashkësi legjitime në mes të njerëzve të lirë dhe skllevërve”, dhe pronarët e skllevërve vendosnin për kohën dhe personin më “të përshtatshëm” për skllevërit e tyre. Skllevërit zakonisht



“CIGANËT” TË NJOHUR SI “ZAVRAGI”

*Ishin diku 300 nga këto familje, të cilët ishin përfshirë në kategorinë e udhëheqësve të arinjve.*

“CIGANËT LAIESHI/LAYASHI”

*Zakonisht vendoseshin në periferitë e fshatrave, këta romë punonin me hekur dhe bënin kazanë avulli.*

“NETOTSI”

*Ishin diku pesëdhjetë familje të “Netotsi” (rumanisht për “Hottentotët”), të cilët kishin ardhur nga Gjermania.*



DOKUMENTET E EMANCIPIIMIT

III. 8 (përkthyer nga 2000, f. 130)

*Lirimi i skllavërve përmes dokumenteve të emancipimit ishte një mundësi për pronarin të shpreh falënderim për një jetë të kaluar në shërbimin e tyre. Në mesin e shekullit të 19-të, një dokument i tillë i emancipimit, që i ishte lëshuar një rrobalarëseje, lexonte si në vijim:*

*“Përmes kësaj unë shpall se Cigania Mary, vajza e Dumitru Cracau dhe pasardhëse e skllavërve që i kam trashëguar nga prindërit e mi, e mbetur e ve me vdekjen e burrit të saj, për shkak se ka shërbyer me devotshmëri dhe ngrohtësi pasi që ishte një fëmijë që u rrit në oborrin tim, duke iu përkushtuar punës me tërë qenien, në atë mënyrë që gjithmonë ka tërhequr falënderimin tim dhe të gruas time; përmes këtij dokumenti që e vendos në duart e saj unë e liroj atë nga skllavëria dhe i mundësoj të shkoj kurdo dhe kudo ajo dëshiron; për aq sa ajo dëshiron të qëndrojë në oborrin tim, pa ndonjë pengesë ajo do të ketë dhomën ku jeton dhe racionet, sikurse të gjithë skllavërit e tjerë që jetojnë në oborr. Kjo do të jetë një shembull gjithashtu për djalin e saj Dinca, i cili, nëse sillet po aq mirë sa nëna e tij, ai do të lirohet brenda kohës së caktuar. Data 18 qershor, 1849, Dimitrie Canta, kontabilist.”*

III. 9

*Portret i një gruaje rome, Bukuresht, pjesa e dytë e shekullit të 19-të.*

(nga Gronemeyer / Rakelmann 1988, f. 171)

martoheshin shumë të rinj, në mënyrë që të bënë shumë fëmijë dhe të rrisnin pasurinë e pronarit.

Nëseskllavërit ikin nganjësituate e keqe, pronarët e skllavërve dhe trashëgimtarët e tyre legjitim, sipas zakoneve të vendit, gjithmonë kishin të drejtën e rimarrjes së skllavërvetë iku, ngakushdo, pasi që nuk kishte periudhë të kufizimit për skllavërit e Moldavisë”.

Edhe pse më konciz, Kodi i Wallachisë përmbanteparimet e njëjta: “Ciganët do të lindin vetëm skllavë; kushdo i lindur nga një nënë skllave gjithashtu do të bëhet skllav; pronari nuk ka të drejtë në jetën e skllavtë të tij; të drejtat e pronarit ndaj skllavëve do të kufizohen në shitjen ose dhënien e tij; Ciganët pa pronar do të jenë skllavë të princit; martesat në mes skllavërve do të njihet; ndarja do të shpallet kur ndodh një martesë në mes të një skllavi dhe një personi të lirë pa diturinë e pronarit”.

Këto ishin kushtet kryesore të përcaktuara me ligj deri në shfuqizimin e skllavërisë në dy principatat rumune.

ASPEKTET E JETËS SKLLAVE

Gjurmët e skllavërisë u ngulën në kujtimet e ish pronarëve dhe skllavërve të tyre, dhe periudha e skllavërisë la gjurmë në raportet në mes të pasardhësve të këtyre dy shtresave sociale deri më sot.

Në mesin e “Ciganëve”, dallimi në mes “Layashi” dhe “Vatrashi”, romëve nomad dhe të vendosur, dëshmon të jetë vendimtar në shumë mënyra. “Vatrashi”, pavarësisht se kujt i përkisnin, princit, manastireve apo personave privat, në tërësi vuajtën nga kushte shumë të këqija, ndërsa jeta e romëve nomad, e cila madje krahasohej me disa

kategori të popullsisë shumicë, kishte përparësi domethënëse. “Vatrashi” konsiderohej nga pronarët e tyre kryesisht si vjedhës përtacë dhe gënjeshtarë, të cilët bënë çfarëdo ishte e nevojshme për ti iku detyrave të tyre. Dënimi jepej me kamxhikun e pronarit. Dënimi më i zakonshëm ishte goditjet në shpinë me shkop lajthie. Numri i goditjeve radhitej nga dhjetë deri në dyqind apo treqind, që jepeshin me disa herë. Edhe lëkurat më të forta dorëzoheshin pas dyzet ose pesëdhjetë goditjeve, dhe rridhnin gjak të tepruar.

Kasollet e romëve kishin kulmet me baltë dhe kashtë si dhe oxhak. Dritarja e papafingos mund të shihej në murin e prapmë. Një “salash” i “Ciganëve” ngjishej në secilën kasolle, përbërë nga babai, nëna, nganjëherë gjyshi ose gjyshja dhe të gjithë fëmijët që nuk goditeshin nga sëmundjet e shpeshta si

III. 11

Një “shatra” (vendbanim i skllëvërve) në Wallachia, 1862

(nga Hancock 2002, f. 18)

De la fii și moștenitorii  
de răposatului  
SERDAR NICOLAE NICA  
de București  
sunt

**200**

de familie de țigani  
de vânzare.

Bărbații sunt sclavi excelenți de curte, adică țigani de moșie și aurari, cismari, muzicanți, și muncitori agricultori. Vânzarea nu osa conțina de mai puțin de cinci sclavi pã rînd. Prețul pe persoană atunci osa fie doua ducate. Osa fie preparati ca deobicei și bazat pe primirea banilor, cumpărătorul. Va fi asigurat de un serviciu adecvat.



III. 10

Emancipimi i romëve ishte rezultat i disa ligjeve: Rregulloreve Organike të vitit 1831, ligjeve të vitit 1843 dhe 1844 për romët e pronësuar nga shteti, ligjit të vitit 1847 për romët e pronësuar nga kisha, dhe ligjeve të 1855 dhe 1856 ata të pronësuar nga individët privat. Sidoqoftë, tregtia me skllëvërit romë vazhdoi deri në vitin 1845, sikurse shihet nga ky njoftim për një ankand të skllëvërve, që u paraqit në gazetën Luna të Bukureshtit në vitin 1845. Kjo ishte përmbajtja:

“Nga djemtë dhe trashëgimtarët e Serdar Nicolae Nica nga Bukureshti, ekzistojnë 200 familje cigane për shitje. Meshkujt janë skllëvër të shkëlqyer të oborrit, që do të thotë skllëvër të pronës: pastrues të arit, këpucar, muzikantë dhe punëtor të fushave. Shitja do të përbëhet prej jo më pak se pesë skllëvër në të njëjtën kohë; çmimi do të jetë dy dukatë. Ata do të përgatiten në mënyrën e tyre të zakonshme, dhe me rastin e pagimit blerësi mund të sigurohet për shërbim më të vëmendshëm”.

(nga Hancock 2002, f. 24)

pasojë e mjerimit dhe varfërisë në të cilën jetonin. [III. 11]

Një numër i grave, të gjitha rome, ishin përgjegjëse për përkujdesjen e dhomës së fjetjes së pronarit, duke e pastruar, nxehur, rregulluar shtratin, përgatitjen e banjës, dhe në shumë raste, përkujdesjen e të gjitha aspekteve të higjienës së tij personale. Gratë më të bukura shpesh dërgoheshin të bënin masazhin e këmbëve të vizitorëve të rëndësishëm. Interesi i padronit në to i shtynte ato në oborr, në shërbimin e tij direkt personal. Këto gra të reja ende jetojnë në punimet e piktorëve dhe shkrihtarëve të kohës. [III. 9]

Obligimet e “claca” (punës) për pronarin i vendosnin skllëvërit romë në një situatë të varfërisë së skajshme, që formësonin pozitën e tyre shumë të vështirë ekonomike dhe shoqërore në periudhën pasuese. Çështja që u ngreh për

shumicën e romëve të ndenjtur ishte e thjeshtë: Si mund të punon dikush gjysmë viti për pronarin dhe të ketë kohë të fitojë mjaft për një familje që të mbijetojë? Ata ishin fermerë, dhe ditët e kaluara në shërbim të pronarit harxhonin tërë kohën e mirë vetëm që të punonin tokën e tij. Është e pamundur të lëvrohet, të mbillen drithërat, prashiten të mbjellat dhe të korren në fund të sezonit nëse ndokush i ka borxh pronarit deri në 150 ditë punë për një vit. Prandaj, njeriu ose duhej të punonte për pronarin dhe të mbetej i uritur, ose të punonte arën e tij dhe të paguaj borxhin.

Romët nomad, “Rudari”, “Aurari”, “Bayashi”, “Ursari”, “Lingurari”, dhe “Layashi”, të cilët ishin përgjegjës për një pjesë të konsiderueshme (më shumë se gjysma në kohët e mëhershme, afërsisht një e treta në vitin më 1850) të popullsisë rome, gëzonin një lloj të

veçantë të autonomisë. Ata kishin një udhëheqës— “jude” ose “juge”— i pranuar nga autoritetet në Wallachi dhe Moldavi, i cili mbante drejtësinë në “salash” e tij bazuar në traditat rome. Obligimet e tyre ndaj taksave në shumicën e rasteve ishin më të vogla sesa pjesa tjetër e popullatës. Ata ishin të lirë të lëviznin dhe, që me gjasë ishte më e rëndësishmja, nuk kishin obligime tjera të ndryshme, si për shembull “claca”. Duhet të theksohet se mënyra e tyre nomade e jetesës ishte stinore, sepse ata kalonin një pjesë të vitit – zakonisht dimrin – në pronat përkatëse të pronarëve të tyre.

#### FILLIMET E EMANCIPIIMIT

Ideja e emancipimit të skllëvërve ngadalë u ngrit në shoqërinë rumune në kontekstin e një zhvillimi të përgjithsh-




III. 12  
Studentët rumun publikisht djegin statutet e skllavërisë në Bukuresht me 25 shtator, 1848 (nga Hancock 2002, f. 27)

Në Shpalljen e 11 qershorit 1848 thuhet:

“Populli rumun ndërpret praktikën e panjerëzishme dhe çnderuese të skllavërisë dhe shpall lirinë e Ciganëve të pronësuar nga individët privat. Ata të cilët kishin përjetuar turpin e pronësisë së skllavërve janë falur nga populli rumun, dhe atdheu nga thesari i tij do ta kompensoj secilin që përjeton humbje si rezultat i kësaj vepre të krishterë.”

Romët e vendosur më vonë ishin vlerësuar me 8 dukatë ndërsa nomadët me 4 dukatë.

III. 13 (nga Arhivele Nationale Istorice Centrale (ANIC), Arkivi Historik Kombëtar Rumun)



III. 14  
“Dekreti për Emancipimin e të gjithë Ciganëve në Principatën Rumune” i nxjerrur nga Princi i Stirbeit me 8 shkurt, 1856. Me këtë dekret më në fund të gjithë romët në Moldavi dhe Eëllachi ishin njerëz të lirë. (nga ANIC)

hëm drejt paraqitjes së elementeve evropiane në kushtet socio-politike. Në mesin e hapave të parë, një Kuvend i jashtëzakonshëm popullor ishte thirrur për ti rishikuar Rregulloret Organike (aktet themelore të legjislacionit) për Wallachi dhe Moldavi. Në vitin 1831 kuvendi propozoi themelimin e një komiteti hetues për të identifikuar kushtet jetësore të skllavërve dhe pastaj të gjejnë mënyrat për ti përmirësuar ato duke inkurajuar skllavërit të vendosen në mënyrë të duhur dhe ti drejtohen bujqësisë. [III. 6]

Një amendament rekomandonte që “këta Ciganë do të vendosen dhe do ti paguajnë të gjitha taksat në mënyrë të njëjtë sikurse të gjithë fshatarët e taksuar në një pronë; ata që nuk kishin banim të caktuar (që jetonin në tenda) nuk do të jenë të lirë të vendosen në një pronë pa marrëveshjen e pronarit”. Sipas tij,

nevojitej të bindeshin nomadët që të vendoseshin në mënyrë që të paguanin taksa më të ulta, sikurse gjithë fshatarët tjerë. Me gjasë ekzistonte një numër i madh i nomadëve në atë kohë, që do të shpinte në urgjencën e politikës së vendosjes; politikat e tilla ishin të prera pas emancipimit. Situata e romëve, që gradualisht filloi të dukej si “çnderim” për imazhin e popullit rumun, ishte në qendër të debatit intelektual gjatë dekadave të mesme të shekullit të 19-të. Gjërat ndryshuan, dhe skllavëria u shfuqizua për romët në pronësi të shtetit sipas Dekretit të 22 marsit, 1843; të gjithë ata që i paguanin taksat autoriteteve të burgut Vornicia (Romët e pronësuar nga shteti) u futën nën autoritetin e prefektëve të distrikteve, një masë që i emancipoi ata nga skllavëria dhe i vendosi në kategorinë e rumunëve që i nënshtroheshin taksimit personal. [III. 10]

**EMANCIPIMI I ROMËVE  
TË PRONËSUAR NGA KISHA.  
DEKRETI I 1847**

Faza tjetër në procesin e emancipimit ndodhi në vitin 1847. Princi Bibesco i Wallachisë dorëzoi një projektligj para Kuvendit Kombëtar për emancipimin e romëve që u përkisnin Metropolisit të Shenjtë, peshkopëve dhe manastireve, dhe në mënyrë unanime u miratua me 11 shkurt, 1847. Me 2,088 familje rome, manastiri i Cozia kishte numrin më të madh të skllavërve, fal bamirësisë së mëhershme të Voivode Aleksandri i Mirë. Distrikti Prahova gjithashtu kishte 8,870 individë romë, dhe udhëhiqte në këtë aspekt. Në distriktet e Wallachisë jetonin 47,245 Romë, në 11,446 familje, të cilët ishin ish skllavër të manastireve. Nga statistikat e mëtejme, është vlerësuar



ar se në vitin 1850 jetonin diku 250,000 deri 300,000 romë në dy principatat. Kështu që, ata përbënin diku 7.5 për qind të gjithë popullsisë.

## FUNDI I SKLLAVËRISË

Emancipimi i skllavërve të fundit, të atyre pronë e individëve privat, ndodhi në Moldavi në vitin 1855 me nxitjen e Princit Grigore Ghica. Sovrani dërgoi një “ofis” te Këshilli i Jashtëzakonshëm i vendit, duke kërkuar një “projektilig të ri” për emancipimin e romëve të pronësuar nga individët privat në Moldavi. Shfuqizimi i skllavërisë shihej si një reformë që lindi “nga vetë ligjet e humanizmit dhe kryesisht ishte çështje e dinjitetit të vendit”. Princi Ghica e sqaroi këtë moment historik: “Kur Evropa tregon një interes të mirë në principatat dhe intervenon në ardhmërinë e

tyre, populli ynë kanë një detyrë për të ndërmarrë një hap përpara.” Skllavëria konsiderohej si “një gjurmë e shoqërisë barbare”, “një anomali që duhet zhdukur”, “që bie ndesh me dogmat e shenjta krishtere, me parimet e humanizmit dhe interesat vitale të shtetit”.

Në pajtim me idenë e princit, drafti përmbante dy elemente themelore: “Shfuqizimin e menjëhershëm të skllavërisë në Moldavi”, dhe “Rregulloret dhe kushtet që qeverisin shpërndarjen e kompensimit adekuat ndaj pronarëve.” 28 Nëntori ishte shpallur festë kombëtare. Me 22 dhjetor, 1855, “Divan” (kuvend kombëtar) miratoi “Dekretin për përfundimin e Skllavërisë, Rregulloren e Kompensimit dhe Transformimin e Skllavërve të Emancipuar në Taksapagues.”

Lidhur me kompensimin për pronarët, romët “Lingurari” dhe “Vat-rashi” (të vendosur në fshatra) ishin

vlerësuar 8 dukatë dhe “Layashi” (nomadët) 4 dukatë, pavarësisht nga gjinia; vetëm invalidët dhe bebet ishin të lirë nga pagesa.

Situata e skllavërve romë në Wallachia kishte marrë drejtimin e njëjtë sikurse në Moldavi. Me 8 shkurt, 1856, Princi i Stirbeit nxori “Dekretin për Emancipimin e të gjithë Ciganëve në Principatën Rumune”. Përmes tij u shpall fundi i skllavërisë dhe lirimi i të gjithë “Ciganëve” në këtë kategori, të cilët menjëherë u regjistruan si taksapagues të shtetit. Shuma prej 10 dukateve ishte caktuar si kompensim për secilin ish pronar të skllavërve. 8 shkurti u bë festë kombëtare. [III. 14]

Pas emancipimit të tyre, romët vazhduan të formojnë një grup të taksapaguesve në mëshirë të fermerëve dhe autoriteteve lokale. Disa nga ta migruan në qytete, dhe një numër i barabartë u larguan nga Rumania.

## PËRFUNDIM

Përshkrimi i skllavërve romë në Wallachia dhe Moldavia nuk është i qasur nga interpretimet një dimensionale. Nëse dëshirojmë të bëjmë vrojtime të përgjithshme nga pikëpamja e sotme, atëherë me gjasë çështja më

e rëndësishme është pozicioni relativ i romëve nomad dhe të vendosur. Ndërsa romët e vendosur (“Vatrashi”) jetonin në dispozicion të pronarëve të tyre, nuk gëzonin të drejta personale, shpesh dënoheshin ashpër, dhe shiteshin si mallra, romët shëtitës (“Layashi” dhe të tjerët) shpesh gë-

zonin një numër të lirive dhe madje privilegjeve që shumica e shtresave sociale të banorëve lokal nuk i kishin. Këto dallime mund të gjurmohen deri në ditët e sotme në dallimet në mes të grupeve të romëve në Rumani, dhe deri në një nivel të caktuar, atyre në tërë botën.

## Bibliografia

Achim, Viorel (2004) *The Roma in Romanian History*. Budapest: Central European University Press | Georgescu, Alexandru / Sachelarie, Ovid (1982) *Judecata domneasca în Tara Româneasca si Moldova. 1611-1831*. București: Ed. Academiei | Gronemeyer, Reimer / Rakelmann, Georgia A. (1988) *Die Zigeuner. Reisende in Europa*. Köln: DuMont Buchverlag | Hancock, Ian (1987) *The Pariah Syndrome. An account of Gypsy slavery and persecution*. Ann Arbor, Michigan: Karoma Publishers | Hancock, Ian (2002) *We are the Romani People. Ame sam e Rromane džene*. Hatfield: University of Hertfordshire Press | Kogălniceanu, Mihail (1891) *Dezrobirea tiganilor*. In: Ionescu, Vasile (ed.) (2000) *O mie de ani de Singurătate*. București: “Aven Amentza”, pp. 175-178 | Marushiakova, Elena / Popov, Veselin (2004) *Segmentation vs. consolidation: The example of four Gypsy groups in CIS*. In: *Romani Studies* 2/2004, pp. 145-192 | Sion, Gheorghe (2000) *Emanciparea tiganilor*. In: Ionescu, Vasile (ed.) (2000) *O mie de ani de singurătate*. București: “Aven Amentza”, pp. 128-174

